

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Maxima Consulting” shpk**

**Neni 1 – Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“Maxima Consulting”** më poshtë do të quhet **“Shoqëria”**.

**Neni 2 – Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 3 – Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Lagjja “Luigj Gurakuqi”, bulevardi “Aqif Pasha”, zona kadastrale nr.8521, kati 2, godina e hotel “Skampa” Elbasan, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

**Neni 4 - Ortakët**

4.1 Ortaket e Shoqërisë jane:

1 – Z. Skënder Balla, i biri i Rrapush dhe i Gushi, i dtl.

08.04.1988, lindur ne Elbasan dhe banues në Elbasan, lagjja “Partizani”, rruga “Mustafa Skuqi”, pallati nr.413/2, mbajtës



i pashaportes me nr.BF2577858 me nr.personal I80408020N,  
i cili zoteron 100% te kapitalit.

## **Neni 5 - Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ne vlerën 100,000 leke i ndarë në 1 pjesë, me vlerë nominale 100,000 Lekë. Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku i vetëm themelues.

Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe shlyer në tërësi nga ortaku themelues.

5.2 Kuotat, me vendim te Ortakëve, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës se shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

## **Neni 6 – Objekti**

6.1 Objekti i Shoqërisë është:

Sherbime Marketingu online, qender telefonie informatike. Aktivitet ne fushen e ofrimit te sherbimeve te ndryshme online; "telefonata ne Web"; Aktivitet kerkimor, perzgjedhje, orientim, trajnim dhe aktivitete menaxheriale dhe profesionale trajnimi me sisteme multimediale dhe sisteme ne largesi; Aktivitet ne fushen e organizimit te seminareve, takime, konferanca, organizime te per gjithshme dhe aktiviteteve te promovimit te imazhit. Aktivitet ne fushen e marketingut ne web. Aktivitet ne fushen e tregtise elektronike edhe per llogari te paleve te treta; Prodhimin, marketingun dhe rishitjen e energjise elektrike te perfshuar nga burime alternative pa kufizime territoriale, te sherbimeve te komunikimit qe rrjedhin nga zhvillimi i teknologjive; Perdorimi i



sistemeve kompjuterike ne fushen e studimit dhe kontrollit, Perdorimi i sistemeve te informacionit territorial 2(GIS). Call center hyres dhe dales; Shoqeria mund te marre pjese ne cilesine e ortakut apo te aksionerit ne shoqeri te tjera tregtare me objekt te njeje ose te ndryshem. Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, ne menyre qe te arrije objektin e lartpermendur, shoqeria mundet gjithashtu te kryeje çdo transaksion lidhur me asetat e luajtshme ose pasurite e paluajtshme, vendosja e pengjeve, hipotekes, barreve si dhe aktivitete te cilat mund te konsiderohen te nevojshme per te arritur aktivitetin e Shoqerise. Gjithashtu shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera te cilat nuk ndalohen nga ligji ne fuqi, te vlefshme dhe me interes per Shoqerine, me ane te pajisjes me licencat e nevojshme, zhvillim aplikacionesh kompjuterike, per software, crm, mbrojtje te dhenash database, promocion, telemarketing, sherbime telefonike, sherbime asistence online. Ndermjetesim ne turizem dentar dhe guida turistike.

### **Neni 7 – Kohëzgjatja**

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **Neni 8 - Kompetencat e Ortakëve**

8.1 Ortakët, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri te tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.

### **Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratori i parë i Shoqërisë është:

- Z. Skënder Balla, i biri i Rrapush dhe i Gushi, i dtl. 08.04.1988, lindur ne Elbasan dhe banues në Elbasan, lagjja "Partizani", rruga "Mustafa Skuqi", pallati nr.413/2, mbajtës i pashaportes me nr.BF2577858 me nr.personal I80408020N.

9.2 Administratori emërohet me vendim të Ortakëve dhe do te qëndrojë në detyrë për një afat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Administratorët emërohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë me vendim të Ortakëve dhe/ose në përputhje me dispozitat ligjore.

### Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor Tirane.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Nënshkruar sot më datë 10.02.2023, nga:

Ortaku:

Z. Skënder Balla

